

VENDIM

Nr 24 datë 03.10.2013

"PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQËRISË "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" sh.a. DHE NISJEN E PROCEDURAVE PER SHITJEN E AKSIONEVE TE SAJ"

Këshilli i Bashkisë Vlorë, mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", neni 8/VI dhe neni 32/d, dhe ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare", Ligjin Nr.10745 date 27.11.2011 "Për një ndryshim në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ligjin Nr.9723 date 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Statutin e Sh.A "Flamurtari Football Club" sh.a. Vendimin e Këshillit Bashkiak "Për Transformimin në shoqëri aksionare të Klubit të Futbollit "Flamurtari", miratimin e Aktit të Themelimit dhe statutin e Shoqërisë Aksionare të Klubit të Futbollit "Flamurtari"; vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.1, datë 07.02.2013 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2013", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë,

VENDOSI

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar te Shoqerise Aksionere "Flamurtari FC" sh.a nga 2.000.000 (dy milion) lekë në 3.500.000 (tre million e pesëqind mijë) lekë
2. Brenda vitit 2013 administrata e Shoqërisë të përfundojë procedurat përkatëse dhe të paraqesë për miratim në Këshillin e Bashkisë projektin për vlerësimin dhe shitjen e aksioneve të shoqërisë.
3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë "Flamurtari Football Club" të ndjekë procedurat ligjore për regjistrimin e vendimit për zmadhimin e kapitalit dhe depozitimin e dokumentacionit përkatës pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
4. Ngarkohet "Klubi i Futbollit Flamurtari" sha, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Etjona HOXHA
KRYETARE



REPUBLICA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT VLORE
Sektori Juridik dhe Funksioneve të Deleguara

Adresa: L. "H. Cakëri" Rr. "Sh. Zeneli" Vlore, Tel.33 23133, Fax.33 23447, E-mail Prefektura.vlore@hotmail.com

Nr 1559/17
prot

Vlore me 22/10/2013

3226/1

28.10.2013

LENDË: Shprehje për Ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Vlorë.

DREJTUAR: Z. Shpëtim GJIKA
Kryetar i Bashkisë Vlorë.

PER DIJENI: Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Në mbështetje dhe zbatim të neneve 6 dhe 14 të ligjit nr.8927, datë 25.07.2002, "Për Prefektin", shprehemi si më poshtë:

1. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr.24, datë 03.10.2013, "Për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë "Flamurtari Football Club" Sh.A, miratohet si procedurë, pasi u njohëm me relacionin shpjegues, dhe ndryshimet në ligjin që rregullon këto marrëdhënie juridike.

2. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr.25, datë 03.10.2013, "Për shpërblim sipas VKM Nr.206, datë 26.03.1998(rast fatkeqësie), miratohet si procedurë.

3. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr.26, datë 03.10.2013, "Për shpërblim sipas VKM Nr.1, datë 07.02.2013 (pagesë vendim gjykatë I formës së prerë), miratohet si procedurë.

4. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr.27, datë 03.10.2013, "Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve kundër vendimeve të dhëna nga INUV", miratohet si kompetencë.

5. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr.28 dhe 29, datë 03.10.2013, "Për pranimin e fëmijëve në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror", kanë karakter individual, kujdes vendimet nuk hyjnë në fuqi menjëherë, por pasi u njoftohen palëve të interesuara.

Shprehja e ligjshmërië si më sipër i njoftohet për zbatim Kryetarit të Bashkisë.

U konfirmua sot më, 17.10.2013



SHOQERIA "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH A
NIPT L171302031
SELIA - LAGJA "PAVARSIA", STADIUMI "FLAMURTARI"
VLORE

VLORE, ME 14.10.2014

Nr Prot.

VENDIM NR 3

IASAMBLESE SE ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE

Sot ne Vlore , ne ditën e katermbedhjete te muajit Tetor te vitit dymije e katermbedhjete , ne Seline e shoqerise "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB " SH A ne Lagjen " Pavarsia " , prane Stadiumit " Flamurtari " u mblodh Asamblea e ortakut te vetem te shoqerise , me pjesmarrjen e :

- Bashkise Vlore

dhe vendosa sa vijon :

1 -Te paraqitet zmadhimi i kapitalit te shoqerise , me :

- Ne baze te Vendimit Nr 24 , date 03.10.2013 te Keshillit te Bashkise Vlore te behet zmadhimi i kapitalit aksioner nga 2.000.000 qe eshte , ne 3.500.000 leke , mbeshtetur ne Ligjin Nr 10745 , date 27.10.2011 - Per nje ndryshim ne ligjin Nr 9901 , date 14.04.2008 « Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare » .

2 Te emeroje si Ekspert Kontabel per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise " FLAMURTARI FOOTBALL CLUB " SH A, Z. RAMAZAN ADEMI , biri i Tefikut , i datelindjes 29.05.1956 , lindur ne Erseke e banus ne lagjen « Pavarsia » , Rruga « Sadik Zotaj » i pajisur me licensen Profesionale Nr . 139 date 30.01.2005 si Ekspert Kontabel i Autorizuar .

3 - Te miratoje Raportin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar ne lidhje me ZMADHIMIN E KAPITALIT AKSIONER , NGA 2.000.000 LEKE NE 3.500.000 LEKE .

Kapitali aksioner nga 2.000.000 leke te kaloje ne 3.500.000 leke (zmadhimi eshte 1.500.000 leke) , si dhe rezervat ligjore te kontabilizohen me 0 leke . Aksione gjithesej 100 e vlera nominale per nje kuote eshte 35.000 leke .

4 - Te heqe mandatin e Emerimit si Ekspert Kontabel per rritjen e kapitalit te shoqerise " flamurtari football club " SH a , Z. RAMAZAN ADEMI , i pajisur me licensen Profesionale Nr . 139 date 30.01.2005 si Ekspert Kontabel i Autorizuar .

5 - Te depozitohet ky Vendim ne QENDREN KOMBETARE TE REGJISTRIMIT .

Te pasqyrohet zmadhimi i kapitalit aksioner ne Pasqyrat financiare te shoqerise .

Sa me siper nenshkruhet prej te pranishmit pa verejtje

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH A

BASHKIA VLORE

KRYETAR I KESHILLIT TE BASHKISE

KRYETARI

EVIS ALLUSHI

SHPETIM GJIKA



SHOQERIA "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH.A.
NIPT L171302031
SELIA - LAGJJA "PAVARESIA"; STADIUMI "FLAMURTARI"
VLORE

Nr. 126 Prot

Vlore 20,10,2014

DEKLARATE

E ADMINISTRATORIT TE SHOQERISE

"FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH.A.

LIDHUR ME ZMADHIMIN E KAPITALIT AKSIONER TE SHOQERISE

Une, Ardi Behari, Administrator i Shoqerise "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH.A. lidhur me zmadhimin e kapitalit te shoqerise deklaroi se:

- a- Shoqeria "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH.A. Vlore eshte krijuar sipas Aplikimit ne QKR dhe I regjistruar ne daten 18,02,2002 me Kapital prej 2 000 000 leke, dhe me vone nuk ka pesuar ndryshime ne zmadhimin e tij. Zoteruesi I ketij Kapitali ne momentin e krijimit te Shoqerise dhe me pas ka qene me aksioner te vetem Bashkia Vlore, e perfaqesuar nga kryetari z. Shpetim Gjika, me shtetesi shqiptare, I cili zoteron 100% te aksioneve te kapitalit.
- b- Mbeshtetur ne ligjin 10745, date 27,10,2011 - per nje ndryshim ne Ligjin 9901 date 14,04,2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" Neni 1, per nje ndryshim Nenit 107, pika 1 ndryshohet si vijon:

Ligji 9901 date 14,04,2008

Neni 107

Kapitali minimal

Shoqeria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 2 000 000 lekë.

DEKLARATE PER ZMADHIMIN E KAPITALIT "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH.A.

Page 1

Ligji 9901 date 14,04,2008

Neni 178

Regjistrimi dhe publikimi i zmadhimit të kapitalit me aktivet e shoqërisë

1. Regjistrimi i vendimit për zmadhimin e kapitalit, sipas nenit 177 të këtij ligji, duhet të shoqërohet nga bilanci, në bazë të të cilit është zmadhuar kapitali, nga konfirmimi i ekspertit kontabël të autorizuar dhe pasqyra e fundit e të ardhurave dhe e shpenzimeve. Aplikimi duhet të përfshijë edhe një deklaratë të administratorëve, sipas së cilës vërtetohet se gjendja e aktiveve të shoqërisë është e tillë që, nëse vendimi për zmadhim do të ishte marrë në datën e aplikimit për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, zmadhimi do të ishte ende i mundur.

Ligji 10745 date 27,10,2011

Neni 1

Në nenin 107, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Shoqëria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 3 500 000 lekë.

- c- Ndryshimet nga pikepamja sasiore e kapitalit aksioner ne fillim te regjistrimit prej 2,000,000 lek dhe kushtit sipas Ligjit 10745 date 27,10,2011 prej 3 500 000 lek me detyrojne qe:

Une te ZMADHOJ KAPITALIN AKSIONER NE KUSHTET E LIGJIT 10745

ME + 1 500 000 LEK; PRA NE TOTAL KAPITALI TE BEHET 3.500.000 LEK

Per sa me siper deklaroi se Zmadhimi i Kapitalit i pergjigjet zbatimit te ligjit 10745 date 27,10,2011- per nje ndryshim ne Ligjin 9901 date 14,04,2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", zmadhim qe i pergjigjet dhe ndryshimet ne Statutin e Shoqerise (te permiresuar).

Kjo deklarate eshte pjese e Depozitimit te dokumentacionit per Zmadhimin e Kapitalit Aksioner te Shoqerise "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH.A. nga 2.000.000 leke ne 3.500.000 leke.

Per sa me siper nenshkruhet prej te pranishmit pa verejtje.

ADMINISTRATORI I SHOQERISE "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH.A.

(ARDI BEHARI)

Ardi Behari

DEKLARATE PER ZMADHIMIN E KAPITALIT "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH.A.

Page 2



Ramazan ADEMI

Auditor i Licensuar

Adresa Lagja " PAVARESIA"
Rruga " SADIK ZOTAJ "
Vlore , Albania

Phone: (+33) 402360

Fax: (+33) 402360

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL

TE AUTORIZUAR

Per zmadhimin e kapitalit te
Shoqerise

" FLAMURTARI FOOTBALL CLUB

“ Sh.a

Nepermjet kontributeve te reja ,
sipas ligjit Nr 10745 , date 27.10.2011 –
Per nje ndryshim ne ligjin Nr 9901 ,
date 14.04.2008 “ Per tregetaret dhe
shoqerite tregetare “





Ramazan ADEMI

Auditor i Licensuar

Adresa Lagja " PAVARESIA " Phone: + 33 400 331
Rruga " SADIK ZOTAJ " Fax: + 33 400 331
Vlore, Albania

Zoterinj!

Une Ramazan Ademi Auditor i Licensuar prane Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar (IEKA) me Licensen Nr 139 date 28.01.2005 me Vendimin e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise Nr 03 Dt. 14.10.2014 jam ngarkuar per kryerjen e misionit te Zmadhimit te Kapitalit te Shoqerise suaj , " **FLAMURTARI FOOTBALL CLUB** " Sh . a VLORE.

- Kapitali aksioner2.000.000 leke

Mbeshtetur ne ligjin Nr 10745 , date 27.10.2011 , per nje ndryshim ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret e Shoqerite Tregtare", neni 1 , per nje ndryshim te Nenit 107 , pika 1 ndryshohet si vijon : " Shoqerite aksionere me oferte private nuk mund te kete nje kapital me te vogel se 3.500.000 leke " kam kryer misionin tim per vleresimin e kontributeve qe kane ndikuar ne zmadhimin e kapitalit te shoqerise " **FLAMURTARI FOOTBALL CLUB** " Sh . a VLORE.

Per kryerjen e misionit tim kam shfrytezuar:

1. Bilancin Financiar te vitit 2013 te Shoqerise " **FLAMURTARI FOOTBALL CLUB** " Sh . a VLORE , se bashku me anekset e tij,(bashkangjitur ketij materiali).
2. Dokumentacionin kontabel te rregjistrimeve te Shoqerise " **FLAMURTARI FOOTBALL CLUB** " Sh . a VLORE .
3. Dokumentacionin Ligjor te Krijimit te Shoqerise, Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise " **FLAMURTARI FOOTBALL CLUB** " Sh . a VLORE.

Te Dhena te Pergjithshme te Shoqerise

Shoqeria " **FLAMURTARI FOOTBALL CLUB** " Sh . a VLORE eshte krijuar me aplikim per regjistrim ne Q K R ne daten 30.09.2011, me Kapital te prej 2.000 . 000 leke e me vone nuk ka pesuar ndryshime ne zmadhimin e tij . Zoterues i ketij Kapitali ne momentin e krijimit te Shoqerise dhe me pas ka qene me ortak te vetem Bashkia Vlore , me shtetesi Shqiptare e cila zoteron 100 % te kuotave te kapitalit .





Ramazan ADEMI

Auditor i Licensuar

Adresa Lagja " PAVARESIA "
Rruga " SADIK ZOTAJ "
Vlore, Albania

Phone: + 33 400 331
Fax: + 33 400 331

Qe nga krijimi i Shoqerise " **FLAMURTARI FOOTBALL CLUB** " Sh. a VLORE, deri sot nuk kemi ndryshime te kapitalit te nenshkuar .

Perfaqesuesi Ligjor i shoqerise eshte Z. Ardi Behari .

Sipas vendimit te Asamblese se Ortakut te vetem te Shoqerise eshte vendosur zmadhimi i kapitalit te shoqerise sipas Ligjit 10.475 date 27.10.2011 , per nje ndryshim ne Ligjin Nr 9901 date 14.04.2008 " Per tregetaret dhe shoqerite tregetare " e konkretisht te ndryshimit te Nenit 107 te Ligjit 9901 , i cili ndryshohet sipas Nenit 1 te Ligjit 10475 me ndryshimin si vijon : " Shoqerite aksionere me oferte private nuk mund te kete nje kapital me te vogel se 3.500.000 leke " . Ky ligj eshte perafruar plotesisht me Direktiven e Dyte te Keshillit 77/91 KEE , date 13.12.1976 " Mbi kordinimin e masave mbrojtese nga shtete antare , te cilat nevoiten per rruajtjen e interesave te antareve dhe te tjereve , per kompanite , sipas kuptimit te paragrafit te dyte te Nenit 58 te traktatit , lidhur me krijimin e shoqerive publike me pergjegjesi te kufizuar , mbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit te tyre , me qellim per ti bere keto masa mbrojtese ekuivalente " .

Vendimi per ndryshimin e kapitalit , mbeshetur ne Ligjin 10475 date 27.10.2011 ka mare baze ligjore me miratimin ne Keshillin Bashkiak Vlore si dhe e miratuar ne Prefekturen po Vlore sipas Vendimit Nr 24 , date 03.10.2013 si dhe autorizon ortakun e vetem te beje ndryshimet e domosdoshme ne kapitalin e shoqerise " **FLAMURTARI FOOTBALL CLUB** " Sh. a si dhe deklarimin e saj pasqyrat financiare e ne QKR .

Nga shqyrtimi i Dokumentacionit rezultoi si me poshte:

Ne bilancin e vitit 2013 ne postin e kapitalit disponojme shumen prej **2.000.000 leke** dhe ne postin Fitime e Humbje te ushtrimit te vitit 2013 kemi humbje ne shumen prej **- 11.445.583 leke** dhe te rezerva shume prej 0 leke .

Keto te dhena do te na paraqiten sipas pasqyres se meposhtme.





Ramazan ADEMI
Auditor i Licensuar

Adresa Lagja " PAVAREsia " Phone: + 33 400 331
Rruga " SADIK ZOTAJ " Fax: + 33 400 331
Vlore, Albania

<i>Fitime dhe Humbje</i>	<i>Viti 2013</i>	<i>Viti 2012</i>
<i>Kapitali</i>	<i>2,000,000</i>	<i>2,000,000</i>
Fitime / Humbje te mbartura	- 5,525,988	- 70,020
Fitime dhe Humbje te ushtrimit	- 11,445,583	- 5,455,968
Fondi i Rezervave	-	-
<i>Totali</i>	- 14,971,571	- 3,525,988

Ne baze te te dhenave te mesiperme e te legjislacionit ne fuqi, Asambleja e Ortakut te Shoqerise " **FLAMURTARI FOOTBALL CLUB** " Sh . a Vlore me vendimin Nr 3 Dt. 12.06.2014 , miratura me Vendimin e keshillit te bashkise Vlore Nr 24 date 03.10.2013 ka vendosur zmadhimin e kapitalit te shoqerise sipas Ligjit 10745 date 27.10.2011 , Per nje ndryshim ne Ligin 9901 date 14.04.2008 " Per tregetaret dhe shoqerite tregetare " Neni 1 , nga 2.000.000 leke qe eshte aktualisht ne 3.500.000 leke (sipas sqarimeve te mesiperme) .

Sipas llogaritjeve te bera , vlera e kapitalit te aksioner behet **3.500.000 leke** dhe eshte ne pronesi te ORTAKUT te Vetem te shoqerise Bashkia Vlore 100 % te aksioneve te shoqerise .

Keshtu posti i kapitaleve ne bilancin e celjes se shoqerise per vitin 2014 do te na paraqitej sipas tabelës se meposhtme:

<i>Permbajtja</i>	<i>Shtesa e kapitalit</i>	<i>Viti 2013</i>	<i>Celje e Vitit 2014</i>
Kapitali Themeltar	1,500,000	- 14,971,571	- 13,471,571
Kapitali Nenshkruar	1,500,000	2,000,000	3,500,000
Rezervat	-	-	-
Fitime te viteve te kaluara	-	5,525,988	5,525,988
Fitime te vitit ne vazhdim	-	11,445,583	11,445,583
Provigjione per reziqe	-	-	-





Ramazan ADEMI

Auditor i Licensuar

Adresa Lagja " PAVARESIA " Phone: + 33 400 331
Rruga " SADIK ZOTAJ " Fax: + 33 400 331
Vlore, Albania

Si perfundim theksoj se zmadhimin te kapitalit i pergjigjen Vendimi i Keshillit te bashkise si dhe bazohet ne Ligjin 10475 date 27.10.2011

Kapitali i shoqerise " FLAMURTARI FOOTBALL CLUB " Sh . a Vlore mbas zmadhimin eshte 3.500.000 leke qe zoterohet nga ortaku i vetem , BASHKIA VLORE me 100 % te kuotave te kapitalit te neneshkruar ,sipas tabelës se meposhtme:

Emri Mbiemri	Pjesmarrja ne Kapital %	Pjesemarrja ne kapital Leke
BASHKIA VLORE	100.0%	3,500,000
Totali	100%	3,500,000

Aksione gjithesej 100 .

Vlera e nje aksioni eshte 35.000 leke



Auditor i Licensuar

Ramazan ADEMI



Vlore me, 14.10.2014

Pasqyra e Fitimeve dhe e Humbjeve
Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2013



Pasqyra e Fitimeve dhe e Humbjeve
Per vitin ushtrimor te mbyllur me daten 31.12.2013

Te Ardhurat	VITI 2013	VITI 2012
1. Te ardhurat qe hyjne ne shifren e afarizmit	3,504,139	39,008,015
Te ardhura nga shitja e prodhimeve te veta	1,049,972	-
Te ardhura nga kryerja e sherbimeve	1,863,334	2,177,499
Te Ardhura nga Shitja e mallrave	590,833	36,830,516
2. Te ardhura te tjera	33,800,000	26,711,429
Shtesa e gjendjes te prodhimit te vet	-	-
3. Te ardhura financiare	-	-
Totali i te Ardhurave	37,304,139	65,719,444
Shpenzimet	48,749,721	71,175,412
Materialet e konsumuara	4,807,871	12,000,828
Kostot e punes	40,335,889	33,682,416
Pagat e personelit	36,308,940	30,590,220
Shpenzime per sigurime shoqerore	4,026,949	3,092,196
Amortizime e cvleresime	609,000	7,579,607
Shpenzime te tjera	590,180	17,912,561
Te tjera	2,406,781	-
Fitime e humbje nga veprimtaria kryesore	(11,445,582)	(5,455,968)
Te ardhura e shpenzime financiare	-	-
> Te ardhura nga invest A Gjata	-	-
> Te ardhura e shpenzime nga interesat	-	-
> Fitime e humbje nga interesat	-	-
> Te ardhura e shpenzime te tjera financiare	-	-
Totali i te ardhurave e shpenzimeve financiare	-	-
Fitimi (humbja) para tatimit	(11,445,582)	(5,455,968)
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	-	-
Fitimi (humbja) Neto e Vitit financiar	(11,445,582)	(5,455,968)
Zbritje te Tjera	-	-
	(11,445,582)	(5,455,968)



“ FLAMURTARI FOOTBALL CLUB ” sh.a

PASQYRA E BILANCIT AKTIV – PASIV
Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Aktivi	VITI 2013	VITI 2012
1 - Aktivet monetare	86	136
> Arka	-	-
> Banka	86	136
2- Derivatet e Aktivet te mbajtura per tregetim	-	-
3- Aktivet e tjera financiare Afat Shkurtera	5,882,920	5,963,396
> Kliente per mallra e sherbime	-	-
>Debitore e kreditore tj	2,000,000	2,000,000
>Shteti , Tatim - TVSH	1,983,663	2,064,139
Te tjera	1,899,257	1,899,257
4- Inventari	385,651	-
.Lendet e para	385,651	-
>Inventar I imet	-	-
>Prodhim ne proces e I gateshm	-	-
> MALLRA PER RISHITJE	-	-
> PARAPAGIME	-	-
>Mallra per rishitje	-	-
> Shpenzime te periudhave te ardheshme	-	-
II - Aktivet Afat Gjata	47,585,304	2,950,901
>Toka	-	-
> Ndertesa - t	6,450,398	-
> Ndertesa - terene sportive	38,774,186	-
>Aktive te tjera- paisje zyre	2,360,721	2,950,901
Totali i Aktivit	53,853,961	8,914,433
T O T A L I I PASIVET E KAPITALI	53,853,961	8,914,433
1- Pasivet monetare	-	-
>Huamarjet	-	-
> Overdraftet	-	-
> Huamarjet e tjera afatshkurtera	-	-
2- Huate e parapagimet	23,770,948	12,440,421
>Te pagushme ndaj furnitoreve	3,778,059	876,123
>Te pagushme ndaj punonjesve	15,736,505	9,977,797
Te pagushme ndaj shteti (T. Fit e TVSH)	2,808,896	913,319
> Te tjera	1,335,918	609,762
> Te tjera	111,570	63,420
3- Pasivet Afat Gjata	45,054,584	-
>Huate afatgjata	-	-
>Huamarjet e tjera afatgjata	-	-
> Grantet etj	45,054,584	-
> Detyrime te tjera ndaj ortakeve	-	-
4- KAPITALI	(14,971,571)	(3,525,988)
>Kapitali aksioner	2,000,000	2,000,000
>rezerva statuore	-	-
>Rezerva Ligjore	-	-
> Fitime te pashperndara	(5,525,988)	(70,020)
> Fitime e humbje te vitit ushtrimor	-11,445,583	(5,455,968)

“ FLAMURTARI FOOTBALL CLUB ” sh.a

PASQYRA E BILANCIT TE REFORMUAR PAS ZMADHIMIT TE KAPITALIT.

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 01 Janar 2014 ,

Aktivi	Celja 01.01.2014	VITI 2013
1 - Aktivet monetare	86	86
> Arka	-	-
> Banka	86	86
2- Derivatet e Aktivet te mbajtura per tregetim	-	-
3- Aktivet e tjera financiare Afat Shkurtera	7,382,920	5,882,920
> Kliente per mallra e sherbime	-	-
> Ortake per zmadhimin e kapitalit	3,500,000	2,000,000
>Shteti , Tatim - TVSH	1,983,663	1,983,663
> Te tjera	1,899,257	1,899,257
4- Inventari	385,651	385,651
.Lendet e para	385,651	385,651
>Prodhim ne proces e l gateshm	-	-
>Prodhim ne proces T V SH	-	-
> Inventari	-	-
> Shpenzime te periudhave te ardhshme	-	-
II - Aktivet Afat Gjata	47,585,304	47,585,304
>Toka	-	-
> Ndertesa	6,450,398	6,450,398
> Ndertesa - Terene sportive	38,774,186	38,774,186
>Aktive te tjera materiale	2,360,721	2,360,721
Totali i Aktivit	55,353,961	53,853,961
T O T A L I I PASIVET E KAPITALI	55,353,961	53,853,961
1- Pasivet monetare	-	-
>Huamarjet	-	-
> Overdraftet	-	-
> Huamarjet e tjera afatshkurtera	-	-
2- Huate e parapagimet	23,770,948	23,770,948
>Te pagushme ndaj furnitoreve	3,778,059	3,778,059
>Te pagushme ndaj punonjesve	19,881,319	19,881,319
Te pagushme ndaj shteti (T. Fit e TVSH)	-	-
> Te tjera	111,570	111,570
> Te tjera	-	-
3- Pasivet Afat Gjata	45,054,584	45,054,584
>Huate afatgjata	-	-
>Huamarjet e tjera afatgjata	-	-
> Grantet etj	45,054,584	45,054,584
> Detyrime te tjera ndaj ortakeve	-	-
4- KAPITALI	(13,471,571)	(14,971,571)
>Kapitali aksioner	3,500,000	2,000,000
>rezerva statuore	-	-
>Rezerva Ligjore	-	-
> Fitime te pashperndara	(5,525,988)	(5,525,988)
> Fitime e humbje te vitit ushtrimor	(1,445,583)	(11,445,583)